



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstine Istok
Municipal Istog

Istog: 02/11/2020

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi / Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Vodoprivredu / Department of Agrikulture, Forestry and Hydro-economy

Ftesë për aplikim

Të gjitha OJQ-të që merren me organizimin e aktiviteteve Rekreative-Hulumtuese që veprojnë në Komunën e Istogut që të aplikojnë me projekt-propozime për : Hulumtimin dhe Sigurimin e tri shpellave në bjeshkët e Istogut. Në projekt duhet të janë të përshkruara qartë objektivat, aktivitetet sa me të detalizuara , si dhe përshkrimi i buxheti. Projekti duhet të jetë sa më i specifikuar në përshkrim pra të ceket në detaj aktivitetet për këtë thirrje .

Përparësi do të kenë ato Organizata që :

1. Që kanë bashkëpunim me një apo më shumë OJQ .
2. Përparësi do të kenë projektet të cilat e kanë përshkrimin e qarte dhe buxhetin e specifikuar.
3. Përparësi do të kenë organizatat që janë nga Komuna e Istogut

Kriteret e përgjithshme që duhet plotësuar për të aplikuar në këtë thirrje:

1. Projekt propozimi i shtypur në formë fizike dhe i vulosur nga aplikuesi;
2. Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
3. Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
4. Të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimit nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin;
5. Dëshmi për përvojën në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën;

Vlera financiare e planifikuar për këtë thirrje është 10,000.00 euro (dhjetëmijë) euro , projektet që tejkalojnë këtë shumë nuk merren parasysh nga komisioni vlerësues.

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekteve është 20.11.2020 deri në ora 15:30 në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e Komunës së Istogut.

Projektet që aplikojnë pas këtij afati nuk do të pranohen nga Qendra për Shërbim me Qytetar.

Për informata shtesë na kontaktoni në : Tel 049 766 534

Me respekt,

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,
z. Lulzim Shoshi,

